



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 328/1 Prot.

Tiranë, më 31.01.2024

V E N D I M

Nr. 5, datë 31.01.2024

**“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2024”**

Në mbështetje të nenit 147/d, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

V E N D O S A:

1. Miratimin e planit vjetor të inspektimeve për vitin 2024, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Njësia e Inspektorëve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani



Lidhja nr. 1. Plani i inspektimeve për vitin 2024

Nr.	Lloji i inspektimit	Objekti i inspektimit	Periudha e realizimit të inspektimit	Organi i inspektuar	Afati i dorëzimit të raportit të inspektimit
1.	Tematik	Ndarja e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023.	15.05.2024 – 31.12.2024	Të gjitha gjykatat.	31.12.2024
2.	Tematik	Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023.	15.05.2024 – 31.12.2024	Të gjitha prokuroritë.	31.12.2024
3.	Tematik	Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2023– 31.12.2023.	15.05.2024 – 31.12.2024	Të gjitha prokuroritë.	31.12.2024
4.	Tematik	Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore për periudhën 01.03.2023 – 31.05.2023.	15.04.2024 – 02.12.2024	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Civile.	02.12.2024
5.	Tematik	Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore për periudhën 01.01.2023 – 01.06.2023.	01.04.2024 – 30.09.2024	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier; Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.	30.09.2024
6.	Tematik	Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023.	15.02.2024 – 29.03.2024	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.	29.03.2024